



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1159/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

rastin nr. KI104/17

Parashtrues

Naser Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës
për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
nr. AC-I-15-0265, të 6 prillit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Naser Berisha nga fshati Bakshi, komuna e Obiliqit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Gani Asllani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), nr. AC-I-15-0265, të 6 prillit 2017.
3. Vendimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 30 maj 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 gusht 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Në të njëjtën datë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërzhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 6 shtator 2017, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta që të paraqesin dëshmi lidhur me datën e pranimit të vendimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës. Në të njëjtën datë, kërkesa iu dërgua Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).
9. Më 8 shtator 2017, Gjykata pranoi konfirmimin lidhur me datën kur parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar vendimi i kontestuar.
10. Më 14 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 14 shkurt 2007, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër R. C. dhe Ndërmarrjes Shoqërore KBI “Kosova Export”, Komuna e Fushë Kosovës (në tekstin e mëtejme: ndërmarrja shoqërore) për rikthimin e disa parcelave të tokës në fshatin Bakshi, Obiliq, të cilat parashtruesi pretendon se ishin konfiskuar nga Z. Z, paraardhës i babait të parashtruesit të kërkesës.
12. Më 6 shkurt 2009, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 231/2007), u deklarua jokompetente për të vendosur rastin dhe padia ju dërgua Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).
13. Më 12 prill 2011, Kolegji i Specializuar (Aktvendim i paspecifikuar) refuzoi kërkesëpadinë, sa i përket paditëses R. C, si të papranueshme.
14. Më 26 prill 2011, AKP, si përfaqësuese e ndërmarrjes shoqërore, parashtroi kërkesë për pezullimin e procedurës në këtë lëndë pasi ndërmarrja shoqërore ishte duke ju nënshtruar procedurës së likuidimit.
15. Më 21 nëntor 2011, Kolegji i Specializuar (Aktvendimi nr. SCC-09-0217), refuzoi si të pabazuar kërkesën e AKP-së për pezullimin e procedurës në lidhje me padinë e parashtruesit.
16. Më 18 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit (Aktvendimi ASC-11-0108), refuzoi si të pabazuar ankesën e AKP-së kundër Aktvendimit (nr. SCC-09-2017) të Kolegjit të Specializuar.
17. Më 26 tetor 2015, Kolegji i Specializuar (Aktvendimi SCC-09-0217) hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të papranueshme *“pasi paditësi nuk ka arritur ta sigurojnë aktvendimin mbi trashëgiminë e trashëgimtarëve të Z. Z.”* për të vërtetuar legjitimitetin e tyre aktiv në rastin konkret.
18. Më 24 nëntor 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar (SCC-09-0217) në Kolegjin e Apelit *“për shkak të shkeljes së të drejtës materiale”*.
19. Më 6 prill 2017, Kolegji i Apelit (Aktvendimi nr. AC-I-15-0265), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit. Kolegji i Apelit, duke vërtetuar Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar, mes tjerash, arsyetoi se:

“Në bazë të procesverbalit të seancës dëgjimore, shumë qartë shihet se paditësit i është bërë me dije se duhet ta sjellë Aktvendimin e trashëgimisë, mirëpo paditësi nuk e ka sjellë këtë, duke u arsyetuar se prona e kontestuar është në emër të [ndërmarrjes shoqërore], andaj nuk mund të merret Aktvendimi i trashëgimisë.

[...]

Ankuesi madje as me ankesë në procedurën ankimore nuk e ka sjellë Aktvendimin e trashëgimisë. Ai në ankesë ka pohuar se kërkesa për të sjellë një Aktvendim të tillë për vërtetimin e legjitimitetit aktiv, është sipas tij e

kundërligjshme, pasi që paraardhësit të tij [Z. Z.] i është marrë prona [...] dhe ai nuk ka pasur pronë për të trashëguar.

Kolegji i Apelit nuk mund të pranoj një arsyetim të tillë të paditësit, për mos dërgimin e Aktvendimit të kërkuar të trashëgimisë, pasi që në bazë të nenit 157 të Ligjit për Procedurën jashtëkontestimore, trashëgimtarët kanë të drejtë të kërkojnë Aktvendimin e trashëgimisë edhe nëse nuk ka pasuri për të trashëguar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Kolegji i Apelit (Aktvendimi nr. AC-I-15-0265) ka shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
21. Parashtruesi specifikon që parcelat e kontestuarra janë tjetërsuar “nga viti 1984-1985 kur është bërë rregullimi i tokave bujqësore nga komasacioni, ndërsa deri në këtë kohë kanë qenë prona private në emër të paraardhësit të babait të [parashtruesit] por në mënyrë arbitrare, pa asnjë bazë ligjore, dhe me keqbesim u janë dhënë në posedim dhe shfrytëzim kolonëve të sjellur nga viset e tjera të ish-Jugosllavisë”.
22. Parashtruesi pretendon që ndërmarrja shoqërore “e përfaqësuar nga [AKP] nuk ka asnjë bazë ligjore që të mbaj si pronare ngastrat kadastrale [...] të cilat i ka fituar pa asnjë bazë ligjore [...] dhe në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollin 1 neni 1 [Mbrojtja e Pronës]” nenin 46 të Kushtetutës dhe ligjet mbi pronën të Republikës së Kosovës.
23. Parashtruesi po ashtu pretendon që “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka legjitimuar të gjitha shkeljet të cilat janë bërë në sistemin monist në kundërshtim me aktet e cekura më lart duke bërë pronar eksproprijuesit”.
24. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Apelit dhe parcelat e kontestuarra “t’i kthehen në shfrytëzim” parashtruesit.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuarra më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuarra] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

28. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën si individ dhe si palë e autorizuar, kërkesën e ka parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

29. Megjithatë, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

30. Gjykata po ashtu i referohet paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

(1) “Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit (Aktvendimi nr. AC-I-15-0265) ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për mbrojtjen e pronës.

32. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit, duke hedhur poshtë padinë e parashtruesit si të pabazuar ka legjitimuar konfiskimin, pa bazë ligjore, të pasurisë së paraardhësve të parashtruesit të kërkesës.

33. Gjykata rikujton se Kolegji i Apelit, refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Kolegjit të Specializuar për arsye procedurale, pasi që parashtruesi nuk ka dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë për të dëshmuar legjitimitetin e tij aktiv në lidhje me kërkesën për kthimin e parcelave të kontestuara dhe nuk e kanë trajtuar në mënyrë specifike vet esencën e kërkesës së parashtruesit.

34. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28).
35. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, para. 65, shih po ashtu, *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
36. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit ka vlerësuar interpretimin e Kolegjit të Specializuar sa i përket dispozitave procedurale në lidhje me legjitimitetin aktiv të parashtruesit.
37. Kolegji i Apelit gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës arsyetoi se Kolegji i Specializuar me të drejtë ka hedhur poshtë padinë e parashtruesit, pasi parashtruesi nuk ka dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë për të dëshmuar legjitimitetin aktiv në lidhje me parcelat e kontestuara.
38. Kolegji i Apelit më tej ka adresuar edhe pretendimin e parashtruesit se nuk ka qenë e mundur që të zhvillohet procedura e trashëgimisë në lidhje me paraardhësin e parashtruesit Z. Z, pasi ai nuk ka pasur pronë për të trashëguar, duke arsyetuar se “në bazë të nenit 157 të Ligjit për Procedurën Jashtë Kontestimore, trashëgimtarët kanë të drejtë të kërkojnë Aktvendimin e trashëgimisë edhe nëse nuk ka pasuri për të trashëguar”.
39. Gjykata konsideron se përfundimet e Kolegjit të Apelit janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesit i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i konsideron të rëndësishme për rastin e tij.
40. Të gjitha argumentet e parashtruesit, të cilat ishin relevante për vendosjen në lidhje me legjitimitetin aktiv të parashtruesit në rastin konkret, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat. Të gjitha arsyet materiale dhe ligjore që lidhen me vendimin e kontestuar u parashtruan në detaje nga parashtruesi i kërkesës, dhe si rrjedhojë, Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).
41. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës në lidhje me të drejtën për mbrojtjen e pronës, Gjykata rikujton që e drejta në mbrojtje të

pronës zbatohet vetëm për pasuritë ekzistuese të një personi dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës (shih: *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës*, nr. 6633/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1879, paragrafi 50).

42. Në rrethana të caktuara “*pritja legjitime*” për përvetësimin e pasurisë mund të gëzojë gjithashtu mbrojtje nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, para. 74).
43. Megjithatë, Gjykata rikujton se “*pritja legjitime*” duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjeshtë një shpresë dhe të jetë e bazuar në një dispozitë juridike ose akt juridik siç është për shembull një vendim gjyqësor. Nuk mund të thuhet se “*pritja legjitime*” paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit kurse, kërkesat e parashtruesve i hedhin poshtë pastaj gjykatat e rregullta (shih: *mutatis mutandis*, *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, Ibidem, para.75).
44. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se rrethanat e rastit nuk i kanë dhënë parashtruesit të drejtë në një interes material të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
45. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat para Kolegjit të Apelit kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës.
46. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 14 nëntor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvete Gërxhalij-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi